

## STATUTI

### i Organizatës "Alumni UP"

Ky statut do të qeverisë shoqatën jofitimprurëse "Alumni UP" e themeluar në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

#### Neni 1

##### Emri, forma dhe adresa

1. Organizata do të quhet "Alumni UP".
2. Ajo mund të njihet edhe si **AUP (shkurtesa)**
3. Organizata është shoqatë jofitimprurëse, sipas definimit të dhënë në nenin 5.2 dhe 6 të Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.
4. Organizata nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo të ardhure neto ose fitimi si të tillë për asnjë person. Pasuria, të ardhurat dhe fitimet e Organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të Organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar përfitime të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthorazi për asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësit, ndonjë anëtar të Organizatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJQ-së. Megjithatë pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona bëjnë për këtë Organizatë.
5. Çdo transaksion ndërmjet OJQ-së dhe një organizate tjetër të ndërlidhur, apo ndërmjet OJQ-së dhe anëtarëve, zyrtarëve, anëtarëve të bordit ose punonjësve të saj ndalohej, përveç, nëse organi drejtues i ndërmjetëm, Bordi Ekzekutiv, vendosë, pas hetimeve të arsyeshme, se transaksioni është në interes, i drejtë dhe i arsyeshëm për OJQ-në, dhe se OJQ-ja nuk kishte mundur të sigurojë marrëveshje më të favorshme me përpjekje të arsyeshme dhe brenda rrethanave ekzistuese.
6. Organizata mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saja jofitimprurëse, në pajtim me paragrafin 1.4 të këtij Statuti dhe nenin 4 të Ligjit për Lirim të Asociimit në OJQ 04/L-57, me kusht që të ardhurat e realizuara nëpërmjet të aktiviteteve ekonomike të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në këtë statut.
7. Organizata e ka zyrën e saj qendrore në Fakultetin e Edukimit - Qendra në Prishtinë Rr. "Agim Ramadani", p.n.10.000 Prishtinë.

**Neni 2**  
**Themeluesit**

1. Themelues të Organizatës janë:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Adresa
1.	Armend Berisha	Rr, "Bregu i Djellit II, nr. 37/37/Prishtinë/Prishtinë
2.	Besnik Loxha	Dardania Su7/4 Ll. D.4, Nr-2/Prishtinë/Prishtinë
3.	Burbuqe Muhadri	Damjan/Damjan/Gjakovë
4.	Elmaze Gashi	Dardania SU 4/7.D.5.nr.14/Prishtinë/Prishtinë
5.	Fis Malësori	Ulpianë D 6 Hyma 5 nr 9/Prishtinë/Prishtinë
6.	Gjylbehare Llapi	Mati 1/Prishtinë/Prishtinë
7.	Hysen Bytyqi	Lagja Dardania Hyrja 9 B/4 Nr. 29/Prishtinë/Prishtinë
8.	Bajram Pakashtica	Rr-Eduard Lir-Arbëri/Prishtinë/Prishtinë

2. Kuvendi i Anëtarëve vendosë për përfaqësuesin e autorizuar të Organizatës, i cili/e cila përfaqëson Organizatën dhe pranon të gjitha shkresat zyrtare në emër të Organizatës. Përfaqësuesi i autorizuar është përgjegjës për informimin e autoriteteve kompetente për çfarëdo ndryshimi në të dhënat e deklaruar në rastin e regjistrimit të Organizatës.

### Neni 3 Misioni dhe Qëllimi

1. **Misioni.** Rrjetëzimi i alumni të Universitetit të Prishtinës në mbështetje të nevojave dhe ndryshimeve pozitive në UP.
  
2. **Qëllimi.** Organizata është themeluar me qëllim të:
  - 2.1 Krijimit të mundësive për alumni të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për të dhënë kontributin nga përvoja e tyre dhe për të qenë pjesë integrale e ndryshimeve pozitive në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.
  - 2.2 Rrjetëzimit të alumni të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.
  - 2.3 Ndërkombëtarizimit të UP-së.
  - 2.4 Nxitjes dhe udhëheqjes së bashkëpunimeve me akterët e rëndësishëm, partnerët ndërkombëtarë dhe vendorë, shoqërinë civile, për ndryshime pozitive në UP dhe më gjerë.
  - 2.5 Mbledhjes së donacioneve në mbështetje të UP-së.
  
3. **Aktivitetet.** Për t’i përmbushur qëllimet e saj, Organizata do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet vetëm në këto lloje të aktiviteteve:
  - 3.1 Rrjetëzimin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të alumni të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.
  - 3.2 Nxitjen dhe udhëheqjen e bashkëpunimeve me akterët e rëndësishëm nga fusha të ndryshme në interes të UP-së. Krijimin e skemave për mbledhje të donacioneve për përkrahje të aktiviteteve të studentëve dhe stafit të UP-së.
  - 3.3 Krijimin e Klubeve të Alumni të Univesitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.
  - 3.4 Forcimin e lidhjes UP, alumni, industri, dhe shoqëri civile për bashkëpunime të frytshme në procesin mësimor, hulumtim, dhe ndërmarrësi.

### Neni 4 Anëtarësimi

1. Anëtarësimi në Organizatë është i hapur për të gjithë të diplomuarit e UP-së pavarësisht prej racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
2. Për t’u anëtarësuar në Organizatë, secili i interesuar duhet të pranojë Statutin dhe Misionin e Organizatës dhe të angazhohet për përmbushjen e qëllimeve të organizatës.
3. Anëtarë të Organizatës, përveç të diplomuarve të Universitetit të Prishtinës, mund të jenë edhe të diplomuarit e universiteteve tjera, si të vendit ashtu edhe të vendeve jashtë Kosovës dhe atë vetëm si anëtarë nderi dhe anëtarë të ftuar.
4. Kuvendi i anëtarëve do të vendos nëse do të kërkohet pagesa e anëtarësimi nga anëtarët.

5. Me rastin e anëtarësimit, çdo i anëtarësuar duhet t'i shërbejë qëllimit të Organizatës pa marrë parasysh se i anëtarësuar është i diplomuar i Universitetit të Prishtinës, anëtarë i nderit apo i ftuar.
6. Kuvendi i anëtarëve do të vendosë për rregullat dhe procedurat e pagesës së anëtarësimit shumë, dhe mënyrën e pagesës, përfshirë marrjen e masave të ndryshme, deri në përjashtimin e anëtarit nga Organizata në rast të mospagesës së anëtarësisë.
7. Anëtarësimi i ndonjë anëtari gjithashtu mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e Kuvendit të Anëtarëve në rast të:
  - 7.1 Mosrespektimit të Statutit të Organizatës
  - 7.2 Keqpërdorimin e të dhënave të Organizatës
  - 7.3 Veprimtarisë në kundërshtim me misionin dhe qëllimin e Organizatës
  - 7.4 Keqpërdorimin dhe tjetërsimin e përfitimeve nga Organizata
  - 7.5 Mospagesës së shumë për anëtarësi
8. Në rast të suspendimit, kohëzgjatja e suspendimit do të përcaktohet.
9. Përfundimi ose suspendimi i anëtarësimit nga Kuvendi i Anëtarëve do të vendoset me shumicë votash të Kuvendit të Anëtarëve.

## **Neni 5**

### **Kuvendi i Anëtarëve**

1. Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë qeverisës i Organizatës. Ai përbëhet prej të gjithë anëtarëve të organizatës.
2. Kuvendi i Anëtarëve ka përgjegjësinë më të lartë për politikën dhe çështjet financiare të organizatës. Në këtë kuadër, Kuvendi i Anëtarëve ka kompetencë të zgjedhë dhe të shkarkojë zyrtarët në pozita udhëheqëse të OJQ-së, të aprovojë raportet periodike financiare dhe të punës, të interpretojë dhe ndryshojë Statutin, si dhe të vendosë për bashkimin, ndarjen apo shuarjen e OJQ-së. Këto përgjegjësi nuk mund të delegohen në organet tjera më të ulta.
3. Përpos përgjegjësi të rezervuara që ka, Kuvendi i Organizatës gjithashtu ka edhe këto përgjegjësi:
  - 3.1 Promovimin e organizatës
  - 3.2 Mbrojtjen e interesave të organizatës
  - 3.3 Kontribuj në organizime për qëllime të organizatës
4. Kuvendi i Anëtarëve delegon të gjitha përgjegjësitë të tij në organin tjetër udhëheqës të ndërmjetëm, Bordin Ekzekutiv, ose edhe të punësuar të Organizatës, me vendimin e shumicës së anëtarëve të tij, me përjashtim të përgjegjësi të cilat nuk delegohen sipas nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe paragrafit 2 të Neni 5 të këtij Statuti.

## Neni 6

### Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve

1. Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku një herë në vit në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV) ku shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar, si dhe plani për mjetet, e detyrimet e parapara, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm.
2. Kuvendi i Anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme (MPJ) kurdoherë që kërkohet nga gjysma e anëtarëve ose nga organet tjera të ndërmjetme. Një kërkesë e tillë duhet t'i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit të anëtarëve i cili do të lajmërojë për takimin të gjithë anëtarët, në pajtim me procedurat e përcaktuara në paragrafin vijues.
3. Lajmërimi me shkrim për MPV dhe/ose MPJ, duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për mbledhjen do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve së paku shtatë ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.
4. Për mbajtjen e mbledhjes është e nevojshme dhe obligative të ftohen të gjithë anëtarët.
5. Mbledhja mbahet me anëtarët prezent dhe vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve prezent. Procesverbali i mbledhjes i dërgohet me postë elektronike të gjithë anëtarëve. Nëse për ndonjë arsye mbledhja nuk mund të mbahet në kohën e paraparë, takimi do të shtyhet për një ditë të përcaktuar më vonë dhe lajmërimi i ri do t'u dërgohet të gjithë anëtarëve.
6. Secili anëtar i organizatës ka një votë në Kuvendin e Anëtarëve.
7. Vendimet në Kuvendin e Anëtarëve do të merren me shumicën e anëtarëve prezent.
8. Asnjë anëtar i Kuvendit të Anëtarëve nuk i lejohet të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje ku ai ka interes direkt apo indirekt ekonomik. Anëtar i Kuvendit të Anëtarëve konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/ajo, ose cilido anëtar i familjes së tij ka interes direkt apo indirekt ekonomik.

## Neni 7

### Organi udhëheqës i ndërmjetëm - Bordi Ekzekutiv

1. Bazuar në përgjegjësitë e dhëna me këtë statut, organi udhëheqës i ndërmjetëm **Bordi Ekzekutiv** duhet të veprojë çdo herë në pajtim me misionin dhe qëllimin e Organizatës.
2. Përgjegjësitë e Bordit Ekzekutiv:
  - 2.1 Bordi Ekzekutiv propozon përfaqësuesin e autorizuar të Organizatës,
  - 2.2 Bordi Ekzekutiv kontrollon implementimin e qëllimit dhe aktiviteteteve të parapara në Statut.
  - 2.3 Bordi Ekzekutiv mbikqyrë punën e zyrtarëve dhe nëpunësve të Organizatës.
  - 2.4 Bordi Ekzekutiv ka përgjegjësinë për mbarëvajtjen e punëve dhe performancën e Organizatës.

- 2.5 Të propozojë zgjedhjen dhe shkarkimin e zyrtarëve në pozitat udhëheqëse të Organizatës;
- 2.6 Të interpretojë dhe propozojë ndryshimin e statutit (gjithmonë duke i shërbyer qëllimit të Organizatës);
- 2.7 Ta ndihmojë Drejtorin Ekzekutiv në sigurimin e fondeve për funksionim e veprimtarisë së Organizatës;
- 2.8 Propozon për bashkëpunimin dhe lidhjen me shoqata e institucione të tjera;
- 2.9 Propozon për shumën, formën dhe mënyrën e pagesës për anëtarësim në Organizatë;
- 2.10 Propozon për modelet dhe nivelet e anëtarësisë;
- 2.11 Përveç Statutit, propozon dhe përpilon akte tjera juridike që i shërbejnë Organizatës;
- 2.12 Sipas nevojës, propozon formimin e grupeve punuese dhe komisioneve;
- 2.13 Siguron proces transparent të aktiviteteve dhe të fondeve dhe atë në përputhje me aktet ligjore në fuqi;
3. Secili anëtarë i Bordit Ekzekutiv do të shërbejë në kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh dhe do të ushtrojë detyrën deri në zgjedhjen e anëtarit të ri. Anëtarët e Bordit nuk mund të ushtrojnë më shumë se 2 (dy) mandate të njëpasnjëshme.
4. Anëtarët e ri të Bordit Ekzekutiv propozohen dhe zgjidhen nga Kuvendi i anëtarëve, me shumicë votash të anëtarëve prezent.
5. Bordi Ekzekutiv do të ketë të paktën 3 anëtarë, njëri nga të cilët duhet të zgjidhet si Kryesues i Bordit.
6. Mandati i anëtarit të Bordit pushon:
  - 7.1 Në rast të vdekjes,
  - 7.2 Dorëheqjes ose
  - 7.3 Shkarkimit nga Kuvendi i Anëtarëve.
7. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit si pasojë e njëres nga arsyet e lartpërmendura në pikën 7 të këtij Neni, Kuvendi i Anëtarëve zgjedh pasardhësin e tij/saj për kohën e mbetur të mandatit.
8. Bordi zgjedhet nga Kuvendi i Anëtarëve. Ata do të zgjedhen individualisht me shumicë të votave nga anëtarët e pranishëm. Mënyra e zgjedhjes, shkarkimit dhe rregullat e punës së anëtarëve të Bordit rregullohen me një Rregullore të veçantë për punën e Bordit, e cila aprovohet nga Kuvendi i Anëtarëve me shumicë votash.
9. Anëtarët e Bordit mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit me shumicë votash të Kuvendit të Asociaconit

10. Vendimet në Bord merren me shumicë votash të anëtarëve prezentë.

11. Bordi mund të vendosë t'i drejtohet për çfarëdo çështje Kuvendit të Anëtarëve për marrje të vendimit.

12. Kurrëfarë pagese ose kompenzimi nuk duhet t'u bëhet anëtarëve të Bordit pa aprovimin e Kuvendit të Anëtarëve dhe vetëm kur pagesa ose kompenzimi është i arsyeshëm dhe bëhet për punën e kryer për Organizatë.

13. Asnjë anëtar i Bordit, përfshirë këtu edhe anëtarët Ex-officio dhe anëtarët e nderit, nuk i lejohet të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje ku ai ka interes direkt apo indirekt ekonomik. Anëtar i Bordit konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/ajo, ose cilido anëtar i familjes së tij ka interes direkt apo indirekt ekonomik.

## Neni 8

### Zyrtarët dhe Nëpunësit

1. Sipas nevojës organizata punëson persona që të marrin përsipër kryerjen e punëve/detyrave ditore të Organizatës.
2. Zyrtari kryesor i organizatës është Drejtori Ekzekutiv.
3. Drejtori Ekzekutiv propozohet nga Bordi Ekzekutiv dhe zgjedhet nga Kuvendi i Anëtarëve.
4. Zyrtarët në AUP duhet të punësohen në përputhje me Ligjin e Punës në Republikën e Kosovës, të gjitha të ardhurat dhe të mirat e tjera që duhet t'i paguhen Zyrtarit, si dhe obligimet dhe përshkrimin e punës dhe përgjegjësi të Zyrtarit. Të gjitha pagesat duhet të jenë të arsyeshme dhe duhet të paguhen vetëm për punën e kryer për organizatë.
5. Drejtori Ekzekutiv i zbaton të gjitha vendimet e marra nga Kuvendi i Anëtarëve dhe informon Bordin Ekzekutiv për progresin e arritur të Organizatës.
6. Drejtori Ekzekutiv e informon Bordin e Ekzekutiv për të gjitha vendimet dhe veprimet e ndërmarra në Organizatë.
7. Përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv:
  - 7.1 Ndhmon në formimin e Bordit dhe grupeve të ndryshme punuese duke përfshirë staf të administratës, profesor, studentë dhe të diplomuar të Universitetit të Prishtinës.
  - 7.2 Vlerëson dhe shqyrton programe të ndryshme Alumni në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, duke mbledhur të dhëna të performancës për t'i paraqitur bordit.
8. Mandati i Drejtorit Ekzekutiv pushon në rast:
  - 8.1 Dorëheqjes
  - 8.2 Vdekjes
  - 8.3 Menaxhimin jo efikas të aseteve
  - 8.4 Shkarkimit nga Kuvendi i Anëtarëve.
9. Asnjë zyrtari apo nëpunësi nuk i lejohet të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje ku ai ka interes direkt apo indirekt ekonomik. Zyrtari apo nëpunësi konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/ajo, ose cilido anëtar i familjes së tij ka interes direkt apo indirekt ekonomik.

**Neni 9**  
**Shpërbërja e Organizatës**

1. Organizata mund të shpërbëhet me vendimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit të Anëtarëve.
2. Kur të vendosë për shpërbërjen e Organizatës, Kuvendi i Anëtarëve do të tregojë emrin e shoqatës ose fondacionit në Kosovë që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jenë paguar borxhet e Organizatës. Shoqata(t) ose fondacioni(et) e zgjedhura duhet të kenë qëllime të njejta ose të ngjajshme sikurse Organizata.

**Neni 10**  
**Ndryshimet e statutit**

1. Statuti i tanishëm mund të ndryshohet me vendimin e dy të tretave e anëtarëve prezentë të Kuvendit të Anëtarëve.

**Neni 11**  
**Periudhat e Raportimit dhe Viti Financiar**

1. Bordi dhe Zyrtarët e emëruar do të paraqesin raporte vjetore para Kuvendit të Anëtarëve, ose kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Anëtarëve.
2. Viti financiar i Organizatës do të përputhet me vitin kalendarik.

Ky Statut është aprovuar në **Prishtinë**

Më **21/09/2018**

Nga Anëtarët e Kuvendit.

**Perfaqësuesja e Autorizuar: Gjylbehare Llapi**

Nënshkrimi: .....

*Gjylbehare Llapi*